

Tema: Praktikrat e rregullimit kushtetues për shpërndarjen e parlamentit-aspekte krahasuese

Abstrakt

Qëllimi i realizimit të këtij punimi të masterit është të hulumtojë praktikrat e rregullimit kushtetues për shpërndarjen e Parlamentit.

Konsideroj se tema paraqet interes të veçantë për çështjen e bazës juridike në aspektin kushtetues për shpërndarjen e parlamentit, ngaqë trajton kushtetutat e vendeve të rajonit si dhe kushtetutës sonë në shpërndarjen e parlamentit në çdo formë. Në pah do të vihen disa elemente, si shpërndarja e Parlamentit në të gjitha situatat e mundshme të cilat parashihen me ligje dhe kushtetutë.

Gjatë punimit të këtij punimi të masterit do të shërbehemi me grumbullimin e materialeve, kryesisht: Kushtetuta e Kosovës, rregulloret e kuvendeve, librat dhe materialet tjera relevante të cilat do të na shërbejnë për punimin e kësaj teme. Besojmë që rezultatet të cilat do të dalin nga ky studim do të jenë dobiprurëse, si dhe do të shërbejnë edhe si mostër për studime të mëtejme në këtë fushë.

Përmes këtij punimi të masterit kemi për objekt studimi praktikrat e shpërndarjes së Parlamentit në aspektin kushtetues si dhe krahasimi me praktikrat e vendeve të rajonit në shpërndarjen e parlamenteve.

Është obligim i secilit të bëjë përpjekje për të paraqitur në mënyrë të drejtë dhe me bazë ligjore dhe kushtetuese se si bëhet shpërndarja e Parlamentit dhe duke bërë karahimin e tyre gjithmonë në aspektin kushtetues.

Në kuadër të këtij studimi, me anë të fakteve, respektivisht ligjeve dhe kushtetutës së Kosovës do të paraqesim praktikrat e rregullimit kushtetues për shpërndarjen e Parlamentit.